




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Radio Aktiv” SH.P.K.
Numri i biznesit - 71312178
Pronar – Elvan HAKU
Radio AKTIV
Rahovec

SHL Kosova
Numri i regjistrimit – 5112123-6
Drejtor – Enis DURGUTI
Rahovec

Ref: 1906/690/LIC/ni

VENDIM

lidhur me ndryshimin e pronësisë dhe transferimin e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale
Audio Radio Aktiv – me seli në Rahovec

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Aktiv është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio (radio) me mbulim lokal, i cili është i licencuar nga KPM për të transmetim tokësorë të radio programeve në komunën e Rahovecit.
3. Radio Aktiv është pajisur nga KPM, me licencë afatgjatë të transmetimit me datën 6 tetor 2009 me afat prej shtat(7) vitesh, pra deri me 6 tetor 2016 dhe e njëjta i është ripërtërirë, në pajtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së, edhe për shtatë (7) vite tjera, që nënkupton se licenca e Radio Aktiv është e vlefshme deri më 6 tetor 2023.
4. Radio Aktiv ka dorëzuar në zyrën e KPM-së, një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratimin për ndryshimin e pronësisë së radio stacionit dhe transferimin e licencës nga “Radio Aktiv” SH.P.K., me numër biznesit 71312178 me pronare znj. Elvan Hasku, tek, Organizata Joqeveritare SHL Kosova me numër të regjistrimit 5112123-6, me drejtor z. Enis Durguti.

5. Me anë të së njëjtës kërkesë kandidati për pronarë të ri të Radio Aktiv, gjithashtu, ka kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e skemës programore.
6. Me datën 6 qershor 2019, kërkesa për ndryshimin e pronësisë dhe skemës programore të Radio Aktiv, është kompletuar me dokumentacion të nevojshëm.

Arsyetim

7. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
8. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
9. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
10. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë së Radio Aktiv thuhet se, arsyeja për ndryshimin e pronësisë është gjendja e vështirë financiare e pronarit aktual.
11. Kërkesa për ndryshim të pronësisë dhe skemës programore nuk përbënë edhe ndryshimin e parametrave teknike të licencës.
12. Kandidati i propozuar për pronar të ri ka shprehur gatishmëri që, ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
13. Kandidati i propozuar për pronar të ri përmes një plani të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka paraparë investime në teknologjinë e transmetimit të Radio Aktiv në mënyrë që transmetimi i programit të jetë më kualitativ.
14. Kandidati për pronar të Radio Aktiv, si pjesë e kërkesës për ndryshim të pronësisë ka bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare sa i përket qëndrueshmërisë financiare.
15. Komisioni konstaton se, kandidati për pronarë të ri ka propozuar një skemë të re programore të Radio Aktiv, e cila përmban rritje të programeve të shërbimit publik, duke ofruar më shume informacione të karakterit lokalë, emisione edukative, me theks të veçantë emisione edukative për të rinj, e cila skemë është në interes të publikut të komunës së Rahovecit.
16. Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë dhe skemës programore të Radio Aktiv nuk do të ndikojë në ndryshimin e zonës së mbulimit.

17. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

VENDIM

18. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 17 qershor 2019, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë së Radio Aktiv dhe transferimin e licencës nga "Radio Aktiv" SH.P.K., me numër biznesit 71312178, pronar znj. Elvan Hasku, tek, OJQ SHL Kosova me numër të regjistrimit 5112123-6, drejtor z. Enis Durguti si dhe ndryshimin e skemës programore sipas kërkesës.

19. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



17.06.2019

datë